



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 813 prot.

Pukë, më 11.05 2026

PROJEKT VENDIM

Nr. 8 datë 11.05.2026

PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” I BASHKISË PUKË

Z. RAMADAN KOPANI

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 1.7, neni 54, germa “m”; ligjit nr. 94/2022 “Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.861 datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhenien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr.71, datë 27.12.2024 “Për miratimin e rregullores së Komisionit Këshillimor “Për titujt vendor të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pukë”, me propozim të kryetarit të Bashkisë Pukë, si dhe pas miratimit të Komisionit Këshillimor për Medaljet dhe Titujve Vendor të Nderit në Bashkinë Pukë, Keshilli i Bashkisë Pukë, në mbledhjen e tij me datë _____.05.2026;

Vendosi:

1. T’i akordojë titullin “QYTETAR NDERI” i Bashkisë Pukë.

Z. RAMADAN KOPANI

Me motivacionin:

“Në vlerësim të kontributit të tij të shquar dhe afatgjatë në fushën e artit skenik, veçanërisht si interpretues i dramës, komedisë, mjeshtëri i monologut dhe i vargut poetik, si dhe për rolin e tij si themelues i zhanrit të humorit në estradën e Pukës. Për vlerat e larta qytetare, integritetin moral dhe përkushtimin ndaj komunitetit, duke kontribuar në pasurimin e jetës kulturore dhe forcimin e identitetit artistik të Pukës.”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë!

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli i Bashkisë Pukë.

Paraqitën projektin;

Drejtori i Menaxhimit të BNJ.

Sokol Gjoni

Juristi

Aida Sinani

Kryetari

Rrok Dodaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 313/1 prot.

Pukë, më 11.05. 2026

RELACION
PËR PROJEKTVEKENDIMIN "PËR DHËNIEN E TITULLIT 'QYTETAR NDERI' TË
BASHKISË PUKË, Z. RAMADAN KOPANI

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Bashkisë Pukë,

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, konkretisht nenit 9, pika 1.7 dhe nenit 54, germa "m", të ligjit nr. 94/2022 "Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", si dhe të VKM nr. 861, datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", paraqitet për shqyrtim dhe miratim pranë Këshillit të Bashkisë Pukë projektvendimi për dhënien e titullit "**Qytetar Nderi i Bashkisë Pukë**" për z. **RAMADAN KOPANI**.

Gjithashtu, projektvendimi mbështetet edhe në **VKB nr. 71, datë 27.12.2024**, "Për miratimin e rregullores së Komisionit Këshillimor për titujt vendorë të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre", e cila përcakton kriteret dhe procedurat për vlerësimin e personaliteteve që kanë dhënë kontribut të veçantë në jetën shoqërore, kulturore, humanitare dhe kombëtare.

Dhënia e titujve vendorë të nderit përbën një akt të rëndësishëm institucional përmes të cilit komuniteti shpreh mirënjohjen dhe respektin ndaj personaliteteve që, përmes veprimtarisë së tyre, kanë lënë gjurmë të rëndësishme në historinë kulturore dhe identitetin qytetar të Pukës.

Në këtë kuadër, figura e z. Ramadan Kopani përfaqëson një nga personalitetet më të njohura dhe më të vlerësuara të jetës artistike dhe kulturore të Pukës, i cili, përmes talentit, përkushtimit dhe veprimtarisë së tij shumëvjeçare, ka kontribuar në mënyrë të spikatur në zhvillimin dhe pasurimin e artit skenik lokal.

Z. Ramadan Kopani është dalluar veçanërisht si interpretues i dramës dhe komedisë, mjeshtër i monologut dhe i vargut poetik, duke sjellë për publikun pukjan dhe më gjerë një krijimtari artistike me vlera të larta estetike dhe qytetare. Përmes interpretimit të tij të veçantë, ai ka arritur të përcjellë emocione, mesazhe shoqërore dhe frymë artistike që kanë mbetur të gjalla në kujtesën kulturore të komunitetit.

Një kontribut me rëndësi të veçantë në veprimtarinë e tij artistike përbën roli si themelues i zhanrit të humorit në estradën e Pukës, duke qenë ndër figurat kryesore që hodhën themelet e humorit artistik lokal dhe që kontribuan në krijimin e një tradite kulturore që vijon të vlerësohet edhe sot.

Përmes angazhimit të tij në jetën artistike dhe kulturore, z. Ramadan Kopani ka ndikuar në edukimin estetik të brezave, në forcimin e identitetit kulturor të Pukës dhe në promovimin e vlerave më të mira të artit dhe qytetarisë.

Krahas kontributit atistik, ai është vlerësuar gjithashtu për integritetin moral, sjenjen qytetare dhe përkushtimin ndaj komunitetit, duke qenë një figurë e respektuar dhe frymëzuese për jetën kulturore dhe shoqërore të qytetit.

Propozimi për dhënie e këtij titulli është shqyrtuar nga Komisioni Këshillimor për Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Bashkia Pukë, i cili, në përputhje me rregulloren përkatëse, ka vlerësuar pozitivisht figurën dhe kontributin e z. Ramadan Kopani, duke miratuar vijimin e procedurës për dhënie e këtij vlerësimi.

Në këtë kuadër, dhënia e titullit “Qytetar Nderi i Bashkisë Pukë” për z. Ramadan Kopani përbën një akt të merituar mirënjohjeje dhe respekti institucional për kontributin e tij të shquar në artin skenik dhe jetën kulturore të Pukës, si dhe një vlerësim për figurën e tij që mishëron vlerat e artit, qytetarisë dhe traditës kulturore pukjane.

Për sa më sipër, propozohet që Këshilli i Bashkia Pukë të shqyrtojë dhe të miratojë projektvendimin “Për dhënie e titullit ‘Qytetar Nderi i Bashkisë Pukë’ për z. Ramadan Kopani”.

Bashkëlidhur:

1. PROJEKT VENDIMI, Nr. 08, datë 11.05.2026

PËR DHËNIEN E TITULLIT ‘QYTETAR NDERI’ I BASHKISË PUKË Z. GJON BERISHA

2. Miratimi i Komisionit Këshillimor.

3. Informimi mbi rezultatin e verifikimit të pastërtisë së figurës për z. Ramadan Kopani

DREJTORI I DREJTORISË SË MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

SOKOL GJONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KOMISIONI KËSHILLIMOR PËR MEDALJET DHE TITUJT VENDOR TË NDERIT

Nr. 313/2 prot.

Pukë, më 11.09 2026

MIRATIM

PËR DHËNIEN E TITULLIT ‘QYTETAR NDERI’ I BASHKISË PUKË

Z. RAMADAN KOPANI

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 94/2022 “Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.861 datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhenien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr.71, datë 27.12.2024 “Për miratimin e rregullores së Komisionit Këshillimor “Për titujt vendor të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pukë”, si dhe VKB nr.70, datë 27.12.2024, “Për krijimin e komisionit këshillimor për medaljet dhe titujt vendor të nderit në Bashkinë Pukë”; pasi u njohëm me materialet dhe dosjen e plotë, përmes së cilës dokumentohet roli i Z. Ramadan Kopani, si një *kontributor i shquar dhe afatgjatë në fushën e artit skenik, veçanërisht si interpretues i dramës, komedisë, mjeshtër i monologut dhe i vargut poetik, si dhe për rolin e tij si themelues i zhanrit të humorit në estradën e Pukës*, shprehemi unanimisht për vlerësimin e tij të merituar nga Bashkia Pukë si “Qytetar Nderi”,

KOMISIONI KËSHILLIMOR

1. Sokol Gjoni

2. Denisa Meçi

3. Endrit Kraja

4. Rasim Laçi

5. Ylli Hadroj

26.04.26

S. Jurek
Z. W. Shkurba



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM



Nr. 237/3 Prot.

Tiranë, më 22.04 .2026

Lënda: Informim mbi rezultatin e verifikimit të pastërtisë së figurës, për Ramadan Kopani propozuar për dhënien e Titullit të Nderit “Qytetar Nderi”.

BASHKISË PUKË

Të nderuar!

Në përgjigje të shkresës nr. 156 prot., datë 29.01.2026, (tonën nr. 237 prot., datë 02.02.2026), të Institucionit të Bashkisë Pukë “Kërkesë për informacion”, drejtuar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti), për verifikimin e figurës për z. Ramadan Kopani, propozuar për dhënien e Titujve të Nderit “Qytetarë Nderi”, bashkëlidhur do të gjeni:

Vendimin nr. 197, datë 16.04.2026 të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Sofi Noti

Në mungesë dhe me Urdhër
Drejtor Drejtorja e Verifikimit të Figurave
Liliana Çoçoli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET
E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT**

Nr. 836/17 Prot.

Tiranë, më 20.04.2026

V E N D I M

Nr. 198 Datë 16.04.2026

Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e datës 16.04.2026, me pjesëmarrjen e anëtarëve:

Z. Albert Nikolla	Anëtar
Z. Altin Hoxha	Anëtar
Z. Gjergj Marku	Anëtar
Z. Skënder Vrioni	Anëtar



shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT:

Kërkesa e paraqitur nga Institucioni i Bashkisë Pukë, me shkresën nr. 166 prot., datë 29.01.2026, "Kërkesë për informacion", për verifikimin e figurës së z. Ramadan Kopani, kandidat i propozuar për dhënien e Titullit të Nderit "Qytetar Nderi".

BAZA LIGJORE:

Ligji nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".

Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga Institucioni i Bashkisë Pukë, me shkresën nr. 166 prot., datë 29.01.2026, sipas objektit të saj,

V Ë R E N:

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" është përgjegjës për zbatimin e ligjit, lidhur me mbledhjen, administrimin, përpunimin, përdorimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe informimin në lidhje me to.

Në nenin 10, pika "dh" të Ligjit nr. 45/2015, një nga detyrat e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit është edhe informimi i individëve, institucioneve kushtetuese, autoriteteve publike dhe subjekteve të tjera të interesuara, sipas këtij ligji.

Nga përmbajtja e shkresës nr. 166 prot., datë 29.01.2026, "Kërkesë për informacion", Institucioni i Bashkisë Pukë, në zbatim të detyrimeve ligjore që rjedhin nga Ligji nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i ka kërkuar Autoritetit nëse disponon informacion, lidhur me z. Ramadan Kopani, kandidat i propozuar për dhënien e Titullit të Nderit "Qytetar Nderi", me përmbajtje sipas shkresës së dërguar nga Bashkia Pukë.

Ramadan Adem Kopani në dokumentet arkivore Regjistër Agjente Dega e Punëve të Brendshme Pukë, ku rezultojnë në cilësinë e bashkëpunëtorit dhe organi që e ka tërhequr është Garda, por këto dokumente të identifikuar nuk lidhen me fushën e veprimit të ligjit nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i ndryshuar, mbi bazën e të cilit ushtron veprimtarinë Autoriteti.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 10, nenin 26 e vijues të ligjit nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike", Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

VENDOSI

1. Të informojë Institucionin e Bashkisë Pukë, për informacionin që kërkohet me shkresën nr. 166 prot., datë 29.01.2026, "Kërkesë për informacion", të kandidatit për dhënien e Titullit të Nderit "Qytetar Nderi", se nga verifikimet e kryera deri tani, sipas përcaktimeve të nenit 30 të Ligjit nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", rezultojnë se z. Ramadan Kopani:

- a) Nuk ka qenë anëtar ose kandidat i Byrosë Politike, anëtar i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, anëtar i Presidiumit të Kuvendit Popullor, Kryetar i Gjykatës së Lartë, Prokuror i Përgjithshëm, Kryetar i Hetuesisë së Përgjithshme, anëtar i Këshillit të Ministrave, kryetar i degëve të punëve të brendshme, anëtar i Komisionit Qendror të Dëbim Internimeve, hetues, prokuror, gjyqtar në procese posaçme politike, apo punonjës i nivelit të lartë i ish-Sigurimit të Shtetit;
 - b) Nuk ka qenë bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, denoncues në proceset politike ose dëshmitar i akuzës në proceset politike të posaçme, pas mbushjes së moshës 18 vjeç;
 - c) Nuk ka qenë person me të dhëna nga ish-Sigurimi i Shtetit për spiunazh dhe terrorizëm.
2. Kopje e këtij vendimi t'i dërgohet institucionit të Bashkisë Pukë.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit.

KRYETARJA

Dr. Gentiana Sula

Në mungesë dhe me Urdhër

ANËTAR

Altin Hoxha

ANËTAR

ANËTAR

ANËTAR

